



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 25 dt.14.02.1996

PER SISTEMIMIN DHE ASFALTIMIN E RRUGES QE FILLON NGA
RRUGA E KAVAJES DERI NE FUSHEN E GRUMBULLIMIT TE
PLEHRAVE SHARRË.

Këshilli Bashkiak i Tiranës, i mbledhur sot me dt.14.02.1996, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, për sistemimin dhe asfaltimin e rrugës që fillon nga rruga e Kavajës deri në fushën e grumbullimit të plehrave Sharrë, duke u mbështetur në vendimin Nr.673, dt.....,1995 “Mbi përdorimin e të ardhurave të pushtetit lokal”,

VENDOSI

1. Të çelet nga të ardhurat e Bashkisë një fond prej 2.450.000 lekë për sistemimin e asfaltimin e rrugës që të çon në fushën e plehrave në Sharrë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Administrimit Financiare.

KRYETARI

BESNIK PETRELA